



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË  
 INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU  
 PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS Ministria e Shëndetësisë	GOVERNMENT OF KOSOVO Ministry of Health	VLADA KOSOVA Ministarstvo zdravstva
---	--	--

## Udhëzim Administrativ (Shëndetësi) Nr. 07/2007

### Masat për zvogëlimin dhe kufizimin e pirjes së duhanit

Ministria e Shëndetësisë,

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2001/9 “Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës”,  
 Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, “Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të  
 Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë”, Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 “Për  
 ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve  
 të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë”,

Bazuar në Ligjin Për Shëndetësi Nr.2004/4 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.  
 2004/31 dhe bazuar në Ligjin Për Duhanin Nr.02/L-36 respektivisht neni 8 , i shpallur  
 me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2007/1,

Mbështetur në Politikën Shëndetësore të Kosovës, shkurt 2001,

Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Shëndetësisë Kosovare 2005-2015,

E vendosur që të arrij standardet ndërkombëtare në sektorin e shëndetësisë,

nxjerr:

Udhëzimi Administrativ - Masat për zvogëlimin dhe kufizimin e pirjes së duhanit

**Neni 1**  
**Qëllimi**



Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen masat për zvogëlimin dhe kufizimin e pirjes së duhanit me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik.

## **Neni 2 Përkufizime**

Të gjitha përkufizimet e cekura në nenin 2 të Ligjit për Duhanin kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë udhëzim administrativ.

## **Neni 3 Reklamimi**

3.1. Me qëllim të zvogëlimit dhe kufizimit të pirjes së duhanit ndalohet çfarëdo forme e reklamimit.

3.2. Nuk konsiderohet reklamë e prodhimeve të duhanit hartimi i udhëzuesve teknik, revistave dhe botimeve tjera profesionale në lidhje me duhanin, rreziqet dhe pasojat nga përdorimi i tij.

## **Neni 4 Shitja**

Shitja e duhanit dhe prodhimeve të tij duhet bërë nga shitësit e licencuar dhe e shoqëruar me të gjitha informacionet për ndikimin e këtyre prodhimeve në shëndetin publik.

## **Neni 5 Promovimi**

5.1. Me qëllim të zvogëlimit dhe kufizimit të pirjes së duhanit ndalohet çfarëdo forme e promovimit të prodhimeve të duhanit.

5.2. Nuk konsiderohet promovim i prodhimeve të duhanit hartimi i udhëzuesve teknik, revistave dhe botimeve tjera profesionale lidhur me duhanin, rreziqet dhe pasojat nga përdorimi i tij.

5.3. Promovimi, më qëllim të parandalimit të pirjes së duhanit bëhet nga:

1. institucionet shëndetësore,
2. institucionet arsimore,
3. institucionet kulturo-sportive,
4. shoqëria civile,
5. mediat.

5.4. Lejohet çdo formë e promovimit kundër pirjes së duhanit.

## **Neni 6 Mbikëqyrja**

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij udhëzimi administrativ bëhet në pajtim me dispozitat e parapara në Ligjin për Duhanin.



**Neni 7**  
**Sanksionet Administrative**

Me qëllim të zbatimit të këtij udhëzimi administrativ, vlejné sanksionet administrative të parapara me dispozitat e Ligjit për Duhanin .

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Prishtinë  
01 Tetor 2007



Sadik Idrizi

*Sadik Idrizi*  
Ministër i Shëndetësisë

